

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga shoqëria **Nestle Bulgaria SHA (Nestlé Bulgaria AD)**, , me seli në Bul. Evropa nr. 128. 1360 Sofje, Bullgari, përmes Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 22.02.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin shoqëria **Nestle Bulgaria SHA (Nestlé Bulgaria AD)**, , me seli në Bul. Evropa nr. 128. 1360 Sofje, Bullgari, synon të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi **ISO-PLUS BG EOOD (ISO-PLUS BG EOOD)**, me seli në Gjueshevë nr. 83, 1379 p.k. Serdika, Sofje, Bullgari, me anë të blerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 13.01.2023, plotësuar më 06.02.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **Nestle Bulgaria SHA**, me seli në Bul. Evropa nr. 128. 1360 Sofje, Bullgari, ku **Nestle Bulgaria SHA**, synon të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi **ISO-PLUS BG EOOD (ISO-PLUS BG EOOD)**, me seli në Gjueshevë nr. 83, 1379 p.k. Serdika, Sofje, Bullgari, me anë të blerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Nestle Bulgaria SHA është një shoqëri aksionare bullgare (Société Anonyme), anëtare e grupit zviceran të kompanive Nestle. Nestlé Bulgaria AD është e përfshirë kryesisht në prodhimin dhe shpërndarjen e pijeve pluhur dhe të lëngshme, produkte për kujdesin e kafshëve shtëpiake, ushqime të gatshme dhe mjete ndihmëse për gatim, ëmbëlsira, produkte qumështi, produkte ushqimore të shëndetshme dhe drithëra. Ndër produktet që i përkasin Grupit Nestle janë vitaminat, mineralet dhe suplementet ushqimore të cilat shiten nën markën "Solgar".

Grupi Nestle ka një kompani ndërmarrje -bijë të themeluar në Maqedoninë e Veriut, shoqërinë Nestle Adriatik Makedonia shpknjp Shkup, me seli në Bulevardin "8-të Shtatori" nr. 16, P.Fah 663, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, Numri amzë nr. 6103820, aktive në shitjen e kategorive të ndryshme të produkteve Nestle.

ISO-PLUS BG EOOD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person, e themeluar siç duhet dhe vepron sipas ligjeve të Bullgarisë, e cila merret me shpërndarjen e produkteve Solgar kryesisht në Bullgari.

ISO-PLUS BG EOOD ka krijuar një filial në Maqedoninë e Veriut, - ISO-PLUS BG EOOD, R. Bullgari - Filial Shkup, me seli Bulevardin Partizanski Odredi 63/1-2, Shkup, NUAS 7140754, aktive vetëm në shitjen e produkteve të markës Solgar.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски